



K.DH.SH.II.nr.1007/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami, kryetar i kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Franciska Zhitija Ymeri, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit NPT “Moni” me seli në Prizren, kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK) me seli në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti Administrativ, Divizioni Fiskal, A.nr.2052/19 të datës 14.06.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 22.11.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti Administrativ, Divizioni Fiskal A.nr.2052/19 i datës 14.06.2021, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti Administrativ, Divizioni Fiskal A.nr.2052/19 të datës 14.06.2021, nën pikën I të dispozitivit të aktgjykimit është aprovuar si e bazuar kërkesëpadija e paditësit NPT “Moni” me seli në Prizren. Në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, është anuluar aktvendimi me nr.01.3.2.2/7293 i datës 29.07.2019, i Doganës së Kosovës në Prishtinë. Në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit, është obliguar e paditura Dogana e Kosovës në Prishtinë, që paditësit NPT “Moni” me seli në Prizren, t’ia kthejë shumën prej 8,848.44€ të paguar më tepër në emër të detyrimeve doganore, për shkak të rivlerësimit të mallit të zhdoganuar përmes Deklarates Unike Doganore me nr.R-14211/16.05.2019 të proceduar në Zyrën Doganore në Prizren, me kamatë ligjore prej 8% nga data e pagesës së taksës doganore, e deri në pagesën e plotë të kësaj shume, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë e paditura Dogana e Kosovës, për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që Dhoma e Shkallës së Dytë ta aprovon ankesën në tërësi si të bazuar në ligj, ndërsa aktgjykimin e ankimuar A.nr.2052/19 të datës 14.06.2021 ta prishë si të pa bazuar në ligj, dhe ta refuzon padinë dhe kërkesën e paditësit në tërësi si të pa bazuar në ligj, duke lënë në fuqi vendimin e kontestuar, ose t’ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, përgjigjen në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të

nenit 49 të LKA, nenit 81.H të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se:

- Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e kundërshtuar nr.01.3.2.2/7293 i datës 29.07.2019 të Doganës së Kosovës në Prishtinë, është refuzuar si e pa bazuar kërkesa e subjektit në procedurë NPT “Moni” me seli në Prizren, për rishqyrtimin e vendimit nr.R-14211/16.05.2019 të proceduar në Zyrën Doganore në Prizren, si e pa bazuar.

Paditësi i pakënaqur me aktvendimin e lartcekur të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 02.09.2019, me pretendim se i njëjti është i pa drejtë dhe i pa ligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër aktvendimit nr.01.3.2.2/7293 i datës 29.07.2019, të Doganës së Kosovës në Prishtinë, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e aprovon si të bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit. Me arsyetim se nga ekzaminimi i vendimit kontestues, gjykata konstaton se e paditura Sektori për Rishqyrtimin e Vendimeve-Dogana e Kosovës ka refuzuar kërkesën e paditësit për rishqyrtimin e vendimit nr.R-14211/16.05.2019 të proceduar në Zyrën Doganore në Prizren si të pa bazuar.

E paditura në vendimin kontestues ka konstatuar se Sektori i Pranimit Qendror ka vepruar drejtë kur ka kontestuar vlerën e mallit lëndor për Deklaratat Unike Doganore, pasi që vlera e mallit e deklaruar për zhdoganim nuk është vlerë reale e paguar për mallin me qëllim të importit në vendin tonë, për arsye se është deklaruar vlerë më e vogël se sa vlera reale e paguar apo që ka për tu paguar për mallin e shitur për eksport përkatësisht për import në vendin tonë në vështrim të nenit 33 të KDAK-së. Po ashtu e paditura në vendimin kontestues ka konstatuar se Sektori i Pranimit Qendror ka vepruar drejtë kur gjatë vlerësimit të mallit është bazuar në metodën e gjashtë të vlerësimit neni 35 të KDAK-së respektivisht në bazë të dhënave të disponueshme të Doganës së Kosovës, zhdoganimeve të mëhershme dhe dosjes së vlerës pasi që këto të dhëna janë marrë nga Sektori i Vlerës, vlerësim ky i cili është bërë duke shfrytëzuar informatat e marra nga zhdoganimet e rregullta nëpër degë. Bazuar në të gjitha këto burime të informatave janë përpiluar edhe çmimet për mallin lëndor të cilat konsiderohen si mjaftë të besueshme dhe pasqyrojnë vlerën reale të mallit lëndor kontestues. Në vendimin kontestues Dogana e Kosovës ka sqaruar se nuk është kontestuese se subjekti në procedurë ka ofruar dokumentacion lidhur me vlerën e deklaruar por dokumentacioni i prezantuar është i pa mjaftueshëm pasi që mungon Deklarata Eksportuese e lëshuar nga shteti eksportues dokument që përdoret nga autoriteti doganor për të kontrolluar eksportet në të cilin evidentohen detaje rreth mallrave që janë të destinuara për eksport, përfshirë edhe çmimin e tyre, andaj Dogana e Kosovës nuk ka mundur të bëjë konstatim tjetër të gjendjes faktike. Nga kjo gjendje faktike, Gjykata vlerëson se e paditura pa bazë ligjore dhe prova materiale të besueshme e ka rivlerësuar mallin lëndor të deklaruar për zhdoganim nga paditësi, përmes DUD-it R-14211/16.05.2019 të ZD Prizren dhe në këtë mënyrë të njëjtin e ka obliguar pa të drejtë me pagesën e detyrimeve shtesë importuese doganore në shumë prej 8,848.44€ mbi vlerën e deklaruar të mallit të importuar.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të dispozitave të nenit 81G të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr. 03/L-222 dhe nenit 38 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore të paditurës për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, këto pretendime ankimore nuk qëndrojnë, meqë gjykata e shkallës së parë ka shqyrtuar padinë, fillimisht i ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje esenciale të dispozitave LKA-së, Ligjit Nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, si dhe të LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, se gjykata e shkallës së parë nuk ka administruara prova për të vërtetuar gjendjen faktike por ato vetëm i ka përmendur dhe ka nxjerr një konkluzion të gabuar duke aprovuar padinë e paditësit, duke konsideruar se aktgjykimi në fjalë përmban shkelje të dispozitave materiale respektivisht në nenit 34 të KDAK-së e që Dogana e Kosovës për vlerën e mallrave të importuar kur nuk mund të përcaktohet në bazë të nenit 33 dhe 34 çmimin e mallrave do të përcakton në bazë të dhënave metodave tjera të parapara në KDAK. Këto pretendime ankimore kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoj, ngase të njëjtat janë të pa argumentuara dhe të pa qëndrueshme në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë. Sepse e paditura me asnjë provë nuk i vërteton pretendimet e saj, ndërsa provat e prezantuara nuk janë me ndikim për vendosje ndryshe të kësaj çështje administrative juridike. Po ashtu, gjykata e shkallës së parë vlerëson se e paditura sikurse në vendimin e parë refuzues me nr. nr.01.3.2.2/7293 i datës 29.07.2019 për rishqyrtimin e vendimeve ka dhënë arsyetim të njëjtë sa i përket bazës ligjore ku e paditura e ka mbështet vendimin e kontestuar. Sipas të paditurës pas rishqyrtimit të kërkesës me shkresat e bashkangjitura në lëndë, vërejtjeve të Gjykatës Themelore në Prishtinë ka konstatuar se malli lëndor kontestues nuk mund të vlerësohet sipas nenit 33 respektivisht sipas vlerës së transaksionit duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Për gjykatën një konstatim i tillë është i pa qëndrueshëm dhe në kundërshtim edhe me udhëzimet e dhëna nga Gjykata kur rasti është kthyer në rivendosje dhe se e paditura ka dështuar të veprojë sipas udhëzimit të dhënë me vendimin e Gjykatës me të cilin rasti ishte kthyer në rivendosje e ku e paditura ishte obliguar që të deklarohet lidhur me provat e administruara dhe atë pro faturën, faturën dhe transaksionin bankar të paditësit, të konstatoj këto pretendime dhe argumente të paditësit dhe si rrjedhojë pas konstatimit të kësaj gjendje faktike të marrë vendim të drejtë dhe të bazuar në dispozitat ligjore të KDA-së. Gjykata nga shkresat e lëndës vlerëson se me asnjë provë nuk është provuar konstatimi i të paditurës i dhënë në vendimin e kontestuar sipas të cilit vlera e deklaruar e mallit lëndor nga paditësi, nuk është vlera reale e paguar e mallit me qëllim importi në vendin tonë në vështrim të nenit 33 të KDAK-së. Gjykata konsideron se e paditura do të mund ta mbështetet një konstatim të këtillë vetëm atëherë kur do të mund të figuronte dëshmi konkrete se paditësi për mallin lëndor kontestues i ka paguar

eksportuesit mbi çmimin neto të faturës të mallit ku vlera e mallit të faturuar nga eksportuesi është paguar nga paditësi përmes Urdhërpagesave Ndërkombëtare me status të aprovuar në bankën TEB Bank të datës 07.12.2018 së bashku me shënimet mbi konvertimin e valutave nga USD në EURO në emër të faturës nr. 18215 të cilat janë në harmoni të plotë në kuptim të shumës së përshkrimit si në fatura. Në këto rrethana rezultojnë se të gjitha dokumentet janë të harmonizuara në tërësi sa i përket vlerës së mallit të importuar nga paditësi në kuptim të nenit 33 par.1 të KDAK-së.

Sa i përket pretendimit për mungesë të deklaratës eksportuese, për gjykatën nuk është i bazuar sepse me dispozitat e Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës nr. 03/L-109 dhe as me dispozitat e UA nr.11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave nuk parashihet deklarata eksportuese për vendosje në qarkullim të lirë të mallit të importuar dhe për tu aplikuar metoda e parë e vlerësimit sipas nenit 33 par.1 të KDAK-së.

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditurës, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se te njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditëses, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.1007/22, me datë 22.11.2023

Kryetar i kolegjit,
Faton Bajrami